



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

---

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në përputhje me nenin 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës Nr.06/L-055, Ligjin për Gjykatat Nr.06/L-054, nenit 6 të Rregullores Nr. 03/2019 për Organizimin dhe Funkcionalizimin e Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit dhe Vendimit KGJK Nr. 438/2023 të datës 31 Tetor 2023, shpall:

**KONKURS TË BRENDSHËM PËR GJYQTARË**  
**të cilët do ta ushtrojnë funksionin e tyre në kuadër të**  
**Departamentit Special në Gjykatën e Apelit**

- Gjykata e Apelit e Kosovës – 1 (një) pozitë për gjyqtar në Departamentin Special

**KRITERET**

1. Për të ushtruar funksionin e gjyqtarit në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe të Apelit, kandidati duhet t'i plotësoj kushtet që kërkohen për emërimin e gjyqtarit në baza të nenit 30 Ligjit Nr. 06/L- 054 për Gjykatat, kushtet e veçanta për gjyqtare te parapara me nenin 32 paragrafi 1, pika 1.1 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 06/L- 054 për Gjykatat, si dhe kriteret plotësuese sipas nenit 5 paragrafi 1, 2 dhe 3 Rregullores Nr. 03/2019 për Organizimin dhe Funkcionalizimin e Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit.

**TE DREJTE APLIKIMI**

Në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë kanë të drejtë aplikimi të gjithë gjyqtarët që plotësojnë kushtet e veçanta për gjyqtar konform nenit 32 paragrafi 1 pika 1.1, 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 06/L- 054 për Gjykatat dhe sipas nenit 5 paragrafi 1, 2 dhe 3 Rregullores Nr. 03/2019 për Organizimin dhe Funkcionalizimin e Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit.

## **FORMULARI I APLIKIMIT**

- formularin mund ta shkarkojnë në Ueb faqen e KGJK-së. ([www.gjyqesori-rks.org](http://www.gjyqesori-rks.org))

[Shkarko Aplikacionin](#)

## **AFATI I DORËZIMIT TË APLIKACIONEVE**

Formularët për aplikim dorëzohen, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga publikimi i konkursit, Sekretariatit e KGJK-së, Rruga "Luan Haradinaj" nr. 133, Prishtinë në Zyrën e Pranimit.

**Data e fillimit të aplikimi: 16 nëntor 2023**

**Data e fundit të aplikimit: 30 nëntor 2023**

## **RREGULLAT DHE PROCEDURAT**

Kandidatëve që aplikojnë për pozitat përkatëse do t`ju kërkohen dokumente të ndryshme për të mbështetur aplikacionin e tyre. Lidhur me këtë çështje, secili kandidat do të kontaktohet individualisht dhe përmes e -mail adresave për t`ju dërguar formularët dhe detajet për procedurat e mëtutjeshme.